

Kryetari i Shtërpcës,
me të drejtë vetoje
për projektin
e Brezovicës



Faqe 2

Nisma niset edhe
në Ferizaj, kundër
një qeverisjeje
aligatorësh




Faqe 5

Kryeministri
në Rahovec,
premtan para për
bagëti e bujqësi



Faqe 5

Komandanti i
NATO-s: Rusia
kërcënon edhe
Moldavinë



Faqe 7

KOHA DITORE



4 198529 302005 0 0029

e hënë • 24 mars 2014

Numri 6014 • Çmimi 0,50 €

www.koha.net

INTERVISTË E BODO WEBER, ANALIST NË KËSHILLIN PËR POLITIKA TË DEMOKRATIZIMIT

Perëndimi s'ka pasur rol në krijimin e FAK-ut tani

Kryeqytetet perëndimore nuk kanë qenë të përfshira në nxjerrjen e vendimit për krijimin e FAK-ut aktualisht, në prag të zgjedhjeve, thotë analisti Bodo Weber. Sipas tij, përkrahja e Berlinit zyrtar për Forcën e Armatosur të Kosovës do të varet nga vlerësimi i ndikimit të themelimit të kësaj force në çështjet e tjera politike që janë relevante për Gjermaninë – posaçërisht për dialogun Kosovë-Serbi

Agron Bajrami

Krijimi i Forcës së Armatosur të Kosovës është pjesë e presionit që Prishtina bën në kërkim të sovranitetit të plotë, por pjesë e së vërtetës së pakëndshme për koso-varët është se Kosova mund ta arrijë sovranitetin e plotë vetëm me ndihmën e Perëndimit. Kështu thotë analisti gjerman, Bodo Weber, ekspert për Ballkanin në Këshillin për Politika të Demokratizimit (Democratization Policy Council).

Në një intervistë për “Kohën Ditore”, Weber thotë se “ka një element të josinqeritetit strukturor në shtytjen e elitave politike për sovranitet të plotë, që ka potencial të ndërlikojë marrëdhëniet e Kosovës me Perëndimin, dhe që shumë lehtë mund të dëmtojë synimet e deklaruara”.

Weber po ashtu thotë se Kosova do të ketë nevojë për njohuritë dhe përkrahjen e Perëndimit në mënyrë që të mund të themelojë një ushtri, ndërsa insiston se me gjithë komunikimin, kryeqytetet perëndimore nuk kanë luajtur rol në nxjerrjen e çështjes së krijimit të FAK-së aktualisht – në prag të zgjedhjeve.

Sipas tij, përkrahja e Berlinit për FAK-un do të varet nga vlerësimi i ndikimit të themelimit të kësaj force në çështjet e tjera politike që janë relevante për Gjermaninë – posaçërisht për dialogun Kosovë-Serbi.

Megjithatë, Weber nuk mendon se krijimi i FAK-ut do të përkeqësojë situatën në veri të Kosovës.

K.D.: Qeveria e Kosovës ka vendosur të transformojë Forcën e Sigurisë së Kosovës në një Forcë të Armatosur të Kosovës (FAK), duke theksuar se është koha që shteti të nisë ndërtimin e një force vërtet ushtarake për të ardhmen. Si e shihni ju këtë hap që po e ndërmerr Kosova?

Weber: Ky hap është qartë pjesë e shtytjes së përgjithshme nga Qeveria e Kosovës për të fituar sovranitet të plotë, të cilën e shohim që nga fundi i pavarësisë së mbikëqyrur. Nocioni i “sovranitetit” që dominon Kosovën është edhe i stërglorifikuar edhe i zbrazët përbrenda.

vijon në faqen e dytë



Më 24 mars mbushen 15 vjet prej fillimit të fushatës së bombardimeve të NATO-s kundër Serbisë, në mbrojtje të Kosovës. Përfshirja e Aleancës Veriatlantike në luftën e Kosovës ka mundësuar, pas fushatës 78-ditëshe, dëbimin e forcave serbe nga Kosova, kthimin e gati një milion refugjatëve shqiptarë dhe instalimin e një administrate ndërkombëtare, e cila ka administruar vendin deri në shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008. Megjithatë, misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, mbetet ende aktiv, ndërsa pavarësimi nuk e ka zgjidhur plotësisht mosmarrëveshjen me Serbinë, me të cilën Kosova tani mban bisedime kryesisht për të zgjidhur çështjen e veriut të vendit, që ende mbetet jashtë kontrollit nga institucionet e shtetit të Kosovës. Sidoqoftë, pa fushatën e NATO-s, që nisi më 24 mars 1999, Kosova do ta kishte pothuajse të pamundur arritjen e shtetësisë dhe të pavarësisë nga Serbia. (Foto nga arkivi i gazetës)

NË MUAJIN QË UP-JA S'PATI REKTOR E AS PROREKTORË, PESË ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES MORËN PAGESA TË MËDHA

Anëtarë të KD të UP-së në shkurt përfituan mijëra euro shtesë

Salie Gajtani

PRISHTINË, 23 MARS- Pesë anëtarët e Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, të zgjedhur nga Senati, kanë marrë nga deri në 7.000 euro të hyra mujore, në muajin shkurt të këtij viti.

Burime të “Kohës Ditore” brenda UP-së bëjnë të ditur se: Behxhet Mustafa, Beqir Sadikaj, Ajvaz Berisha, Safet Merovci dhe Blerim Kamberi, që të gjithë profesorë universitarë të UP-së dhe anëtarë të Këshillit Drejtues, kanë realizuar të hyra të shtuara gjatë muajit shkurt. Në atë kohë, prej këtij institucioni patën dhënë dorëheqjet katër anëtarët e tjerë që kanë qenë të emëruar nga Ministria e Arsimit.

Këto mjete u janë paguar pesësesh së KD-së në kohën kur UP-ja nuk kishte as rektor e as ushtrues detyre të rektorit, apo prorektorë.

Tani drejtues të Rektoratit kanë dhënë disa sqarime në lidhje me të hyrat mujore të këtyre pesë anëtarëve të Këshillit Drejtues, pa mohuar se shumica e tyre arrin deri në afro shtatë mijë euro. Megjithatë, njëri nga pesë anëtarët ka thënë që “kjo nuk është e vërtetë”.

Ardian Gola, zëdhënës në Rektoratin e UP-së ka thënë për gazetën se pagesat për anëtarët e Këshillit Drejtues të zgjedhur nga Senati i UP-së janë si në vijim: 1.143.00 bruto paga bazë për të gjithë stafin menaxhues në të gjitha nivelet, nisur që nga Këshilli Drejtues e deri tek prodekanët.

Pos kësaj, ai ka bërë të ditur se 950 euro “bruto” është shtesa funksionale për postin e anëtarit të KD-së, si dhe 600 euro është honorari-mbi normë. Ai ka sqaruar se “kjo shumë prej 600 eurosh jepet si mbi normë, vetëm nëse profesori i mban orët

mësimore sipas kontratës së punës dhe vetëm në periudhën kur ka proces mësimor”.

Gola, megjithatë, ka konfirmuar se janë bërë edhe pagesa të tjera, por pa i përmendur shumatat e tyre.

Ka thënë se ato janë pagesa të bëra në mënyrë retroaktive si kompensime nga pjesëmarrja e tyre nëpër komisione të ndryshme.

“Pjesa e pagesave të tjera janë realizuar në mënyrë retroaktive, nga puna disamujore në komisione të ndryshme profesionale”, ka thënë Gola. Por më pas Gola ka thënë se në shkurt disa nga honorarët janë paguar në mënyrë retroaktive për 7 muaj.

“Duhet sqaruar se të gjitha pagesat e komisioneve, honorarët për angazhim të personelit akademik dhe pagesat e tjera janë të varura nga krijimi i të hyrave vetjake të UP-së, prandaj në mungesë të këtyre

mjeteve në fazat e caktuara pagesat grumbullohen dhe krijohet “perceptimi i gabuar sikur po merren paga të mëdha”, ka thënë Gola.

I njëjti arsyetim është përdorur edhe kur gazeta pati raportuar, ditë më parë, se edhe sekretari i UP-së, gjatë disa muajve ka marrë të hyra të majme mujore. Ato brenda një muaji kanë qenë deri në mbi 4.000 mijë euro.

Gola, në fund ka thënë se të gjitha pagesat e personelit të UP-së bëhen përmes sistemit të pagave në MAP dhe i nënshtrohen tatimit në pagë dhe kontributit pensional.

Gazeta ka bërë përpjekje për të marrë opinionin e anëtarëve që kanë përfituar nga këto të hyra gjatë shkurtit. Por ka arritur të vërë kontakt vetëm me njërin nga ta, Behxhet Mustafën.

vijon në faqen e gjashtë

Messi vendos “Clasicon”



Ylli argjentinas Lionel Messi ka shënuar “hat-trick” të dielën mbrëma, duke e udhëhequr Barcelonën drejt një fitoreje 4:3 në “Santiago Bernabeu” ndaj Real Madridit. Ndeshja i takoi javës së 29-të të La Ligas spanjolle. Me fitoren e shënuar Barcelona tash u është afruar në një pikë liderëve Atletico Madrid e Real Madrid. Atletico kryeson me 70 pikë, sa ka edhe Reali, ndërsa Barça ka 69 pikë dhe mban vendin e tretë...

Faqe 37

INTERVISTË E BODO WEBER, ANALIST NË KËSHILLIN PËR POLITIKA TË DEMOKRATIZIMIT

Perëndimi s’ka pasur rol në krijimin e FAK-ut tani

Kryeqytetet perëndimore nuk kanë qenë të përfshira në nxjerrjen e vendimit për krijimin e FAK-ut aktualisht, në prag të zgjedhjeve, thotë analisti Bodo Weber. Sipas tij, përkrahja e Berlinit zyrtar për Forcën e Armatosur të Kosovës do të varet nga vlerësimi i ndikimit të themelimit të kësaj force në çështjet e tjera politike që janë relevante për Gjermaninë – posaçërisht për dialogun Kosovë-Serbi

vijon nga ballina

Weber: Ky nocion është produkt i luftërave ballkanike, ndërsa shogëria e Kosovës në mënyrë ironike e ndan këtë, mes tjerëve, edhe me serbët dhe Serbinë. Sovraniteti është një parakusht i rëndësishëm për një shtet dhe ekonomi funksionale, por njeriu nuk mund ta hajë sovranitetin. Gjermania e fitoi sovranitetin e plotë vetëm më 1990, por, përkundër kësaj, ajo i kishte punët mirë ekonomikisht dhe në aspektet sociale. Jam i bindur që Kosova do të arrijë përfundimisht sovranitetin e plotë. Por, është pjesë e së vërtetës së pakëndshme për kosovarët që Kosova mund të arrijë sovranitetin e plotë vetëm me ndihmën e Perëndimit. Ka një element të josingëritetit strukturor në shtytjen e elitave politike për sovranitet të plotë, që ka potencial të ndërlikojë

marrëdhëniet e Kosovës me Perëndimin, dhe që shumë lehtë mund të dëmtojë synimet e deklaruara. Kjo është qartazi e vërtetë për vetë çështjen e FAK-ut – sepse Kosova do të ketë nevojë për njohuritë dhe përkrahjen e Perëndimit në mënyrë që të mund të themelojë një ushtri.

K.D.: Reagimet kanë qenë të ndryshme – derisa Serbia e kundërshtoi këtë, shumë në Perëndim ishin të heshtur, derisa u vërejt se SHBA-ja po e përdor një gjuhë të butë të përkrahjes për atë që e quan një vendim sovran. Mendoni se ka pasur koordinim mes Prishtinës dhe kryeqteteve perëndimore në marrjen e këtij hapi?

Weber: Me sa di, ka pasur komunikim dhe koordinim rreth çështjes tash e ca kohë, por kryeqytetet

perëndimore nuk kanë qenë të përfshira në nxjerrjen e kësaj çështjeje aktualisht, gjatë fushatës zgjedhore, dhe as nuk ishin të gëzuar me këtë. Andaj, qartë ka një përpjekje që vazhdon në kryeqytetet se si të tejkalohen variabelt e ndryshme – dëshira e Prishtinës për sovranitet, që sigurisht se përballet me mirëkuptim dhe njohje, por edhe brenga rreth momentit kur kjo ndodh dhe ndikimit potencial.

K.D.: Përkrahja gjermane për Kosovën ka qenë gjithmonë esenciale, posaçërisht kohët e fundit. Mendoni se Berlini do të përkrahë plotësisht forcën ushtarake të Kosovës, edhe nëse kjo mund të kundërshtohet nga disa aleatë brenda NATO-s?

Weber: Mendoj se niveli i përkrahjes për Kosovën në Berlin nuk do të varet aq shumë nga shtetet e NATO-s që nuk e kanë njohur Kosovën, por do të varet nga vlerësimi i ndikimit të themelimit të FAK-ut në çështjet e tjera politike që janë relevante për Gjermaninë – posaçërisht për dialogun.

K.D.: Serbia ka tërhequr vërejtjen se forca e paralajmëruar ushtarake e Kosovës nuk do të lejohet të veprojë në pjesën veriore të vendit, duke paralajmëruar se Beogradi do të mund të sponsorizojë krijimin e një formacioni ushtarak serb në Kosovën veriore. A munden gjithë këto zhvillime që ndërliohen me krijimin e Forcës së Armatosur të Kosovës të shkaktojnë më shumë trazira në veri?

Weber: Nuk e besoj, sepse Serbia ka nevojë që procesi i afrimit me BE-në të vazhdojë. Andaj, Beogradi më parë do t’u afrohet Berlinit, Brukselit dhe Washingtonit, me kërkesën që të kthejnë prapa çështjen e FAK-ut në një lloj kornize negociuese mes Perëndimit dhe Kosovës me Beogradin, që përpiqet të luajë një rol kur është fjala për veriu.

K.D.: Mendoni se krijimi i FAK-ut mund të ndikojë në dialog, dhe nëse po në çfarë mënyre?

Weber: Mund të ndikojë negativisht në atmosferën e tavolinës së dialogut në Bruksel. Por kjo presupozon që Ashton do të ketë sukses që t’i sjellë të dyja palët në tavolinë në muajt që vijnë, kur, pasi që Qeveria e re e Serbisë të jetë krijuar, fushata e re zgjedhore në Kosovë të ketë nisur.

K.D.: Do të ndikojë ky vendim në operacionet e NATO-s në Kosovë, në misionin e KFOR-it, dhe nëse po, në çfarë mënyre?

Weber: Nuk mendoj se do të ndikojë. Më parë mund të them se misioni i NATO-s do të ndikojë në zbatimin e vendimit për FAK-un.

K.D.: Qeveria e Kosovës sërisht ka theksuar vullnetin e saj për t’iu afruar strukturave të NATO-s, duke u bërë dikur edhe anëtare e plotë. Mendoni se krijimi i FAK-ut është një hap në atë drejtim, apo kjo mund të shndërrohet në një problem për NATO-n, për shkak se disa anëtare



“Dëshira e Prishtinës për sovranitet, që sigurisht se përballlet me mirëkuptim dhe njohje, por edhe brenga rreth momentit kur kjo ndodh dhe ndikimit potencial”

të Aleancës Veriatlantike nuk e njohin ende Kosovën si shtet të pavarur?

Weber: Është zor të imagjinohet afrimi me NATO-n pa e pasur një ushtri. Në anën tjetër, progresi i tillë varet edhe nga performanca e atyre që nuk e njohin Kosovën. Kështu, mund të ndodhë që të shohim një zhvillim paralel me atë të dialogut dhe progresit të Kosovës në integrimet me BE-në.

© KOHA Ditore

ZGJEDHJET MUND TË PROLONGOJNË PROJEKTIN E BREZOVICËS

Kryetari i Shtërpcës, me të drejtë vetoje për projektin e Brezovicës

Visar Prebreza

Prishtinë, 19 mars - Projektin Zhvillimor Turistik i Brezovicës (PZHTB) nuk mund të ecën përpara pa bekimin e kryetarit të Komunës së Shtërpcës Bratislav Nikoliq. Ai e ka të drejtën e vetos në vendimet që kanë të bëjnë me projektin e Brezovicës që janë kompetence e këtij Komiteti. Përveç tij, të drejtën e vetos e ka edhe ministri i Financave, që tashmë është Besim Beqaj. Çështja e vetos përcaktohet në Rregulloren e punës të Komitetit Drejtues Ndërmnistror, të cilën e ka parë “Koha Ditore”. Ky komitet vendos për projektin e Brezovicës, në të cilin pritet të investohen të paktën 300 milionë euro në mënyrë që të arrihet qëllimi i projektit: zhvillimi i një destinacioni të klasit botëror, i cili do të jetë në funksion për turistët gjatë tërë vitit.

Gazeta e ka siguruar dinamikën e realizimit të këtij projekti. Kompanitë që janë në garë e kanë pranuar kërkesën për propozim në fund të muajit shkurt. Deri në fund të muajit prill, kompanitë që janë në garë duhet të përgatitin Draftkonceptin për zhvillim. Më 24 dhe 25 mars pritet të mbahet konferenca paraofertuese, në të cilin pritet të ketë prezantime, ndërsa do të paraqitet edhe kryeministri i vendit, Hashim Thaçi.

Projekti do të marrë edhe mbështetjen e ambasadores së Amerikës, Tracy Ann Jacobson. Në një njoftim të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë, Jacobson, do të flasë për të treguar mbështetjen e ofruar në vazhdimësi nga SHBA-ja ndaj Projektit të Brezovicës përkatësisht investimeve të huaja në veçanti. Kjo konferencë do të jetë një mundësi për investitorët që t’i bëjnë



Sipas dinamikës së realizimit të projektit për Brezovicën, deri në fund të muajit prill kompanitë që janë në garë duhet të përgatitin Draftkonceptin për zhvillim. Më 24 dhe 25 mars pritet të mbahet konferenca paraofertuese

pyetjet dhe kërkesat e tyre rreth projektit. E në ditën e dytë të konferencës, është planifikuar që kompanitë të bëjë vizita në vendet ku pritet të investohet.

Në këtë konferencës përveç ministrit të linjës, Bernard Nikaj, të pranishmëve do t’i drejtohet edhe kryetari i Komunës së Shtërpcës, Bratislav Nikoliq. Nikoliq që e ka të të drejtën e vetos në këtë projekt është paralajmëruar se do të flasë për rëndësinë e këtij projekti për komunën në fjalë, përkrahjen e qytetarëve të kësaj komune si dhe ndikimin e tij në përgjithësi në ekonominë e vendit.

Bazuar në gjedhjet të cilët e ka siguruar gazeta, Qeveria e Kosovës

planifikon që në fillim të muajit qershor të shpallë kompaninë fituese e cila do të marrë në shfrytëzim Brezovicën. Por deri në shpalljen e fituesit duhet të miratohen dokumentet përcjellëse, siç është në draftkonceptin e zhvillimit dhe kontratën përfundimtare të PPP-së, të dyja të nevojshme për aplikim. E miratimin e tyre duhet ta bëjë Komiteti Drejtues Ndërmnistror i projektit, i cili përbëhet nga pesë ministra.

Shpërbërja eventuale e Kuvendit do të pamundësojë marrjen e vendimeve rreth këtij projekti. Projekti i Brezovicës që është iniciuar nga Qeveria e Kosovës do të ndikohet nga procesi i zgjedhjeve parlamentare, nëse ato mbahen në

qershor siç është thënë nga shumë parti politike.

Qeveria synon që projektin ta realizojë përmes partneritetit publiko-privat (PPP) që parasheh dhënien e Brezovicës me koncesion, me një marrëveshje 99-vjeçare. Më saktësisht investitorit do t’i jepen në shfrytëzim rreth 3.500 hektarë në territorit me vlera të rëndësishme natyrore të parkun nacional “Sharri”. Qeveria e Kosovës do të përfitojë dikça më pak se 100 mijë euro në vit në emër të qirasë për shfrytëzimin e kësaj hapësire. Projekti parasheh që fillimisht të bëhet restaurimi i pjesës ekzistuese të Brezovicës, ndërsa në fazën e dytë parashihen investime në projektet e tjera të ngjashme.

Interesim për këtë projekt kanë shprehur 7 konsorciume/kompani. Këshilltari i ministrit të Tregtisë, Lulzim Demolli, ka thënë se Komisioni ndërmnistror i ka parakualifikuar 4 prej tyre, të cilat i kanë plotësuar kriteret e parapara në Shprehje të interesit. Kompanitë që do të vazhdojnë garën për Projektin e Brezovicës janë: ATC Investments, Rilla Investments, MDP Consulting dhe MK Group.

Demolli ka thënë se Projekti Zhvillimor Turistik i Brezovicës (PZHTB) parasheh fillimisht revitalizimin e qendrës ekzistuese të skijimit dhe më pas zgjerimin e saj. “Qëllimi i këtij procesi është që të tërhiqen investitorët privat dhe ekspertë të menaxhimit të cilët mund të sigurojnë që Projekti Zhvillimor Turistik i Brezovicës (PZHTB) është zhvilluar në një destinacion të klasit botëror, i cili do të jetë në funksion për turistët gjatë tërë vitit”, ka thënë këshilltari i ministrit të

Tregtisë dhe të Industrisë.

Qeveria dhe kompania fituese e projektit pritet të lidhin një marrëveshje për qira afatgjate. Investitori do të obligohet të zbatojë planin që e prezanton, të ruajë mjedisin gjatë procesit të investimeve.

Përmes këtij projekti, MTI-ja pret që do të përfitojnë bizneset dhe në këtë mënyrë të ketë ndikim pozitiv në ekonominë e Kosovës.

“Theks i veçantë në këtë projekt bie në krijimin e vendeve të reja të punës”, ka thënë ai, duke shtuar se sektori i hotelerisë zakonisht krijon numër më të madh të punësimit.

Kujtojmë që Kuvendi i Kosovës gjatë këtij viti ka marrë vendim për ndryshimin përmbajtjes së Planit hapësinor për atë pjesë ku parashihet të zhvillohet ky projekt. Konsorciumi Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID) e ka kundërshtuar përmbajtjen e Planit Hapësinor, duke shpreh shqetësimin se ky projekt do të dëmtojë vlerat natyrore në parkun kombëtar ‘Sharri’.

“Projekti për zhvillimin e Qendrës Turistike të Brezovicës parashihet të zhvillohet në 5 zona; A, B (ku gjendet ski qendra ekzistuese), C, D si dhe zonat e brendshme dhe ndërlidhëse. Përqendrimi kryesor mendohet të bëhet në zonën A, ku gjenden vlerat më të rëndësishme natyrore të Kosovës”, thuhet në një komunikatë të lëshuar nga KOSID. “Në zonën A të Projektit Brezovica gjenden dy rezervate strikte të natyrës: Bistra (Ujërat e Humbur) dhe Përroska e Durlës, në të cilat janë të ndaluara të gjitha aktivitetet njerëzore, në veçanti prerjet dhe shkatërrimi i pyjeve dhe ndërtimet”.

© KOHA Ditore